V E N D I M
Nr. 29, datë 23.3.1999

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë e përbërë:

Hilmi Dakli,	Anëtar	i	Gjykatës Kushtetuese
Zija Vuci,	Anëtar	i	“
Alfred Karamuço,	Anëtar	i	“
Kristofor Peçi,	Anëtar	i	“
Kujtim Puto,	Anëtar	i	“
Sokol Sadushi,	Anëtar	i	“

Me sekretare Arbenka Lalica, më datë 26.2.1999, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura kërkesën nr.11 Akti që i përket:

K Ë R K U E S A: QEMAL, MUHEDIN, MUSTAFA E AGIM TOPULLI, të përfaqësuar nga avokatët Liljana Korvafaj e Abaz Brati.

SUBJEKTE TE INTERESUAR: VILSON E ZEQINE TOPULLI, të përfaqësuar nga avokati Gjergj Sauli.

O B J E K T I:

Zgjidhja përfundimtare e kërkesës në rrugë të kontrollit kushtetues, duke shfuqizuar si akt të paligjshëm vendimin nr.1175, datë 20.10.1998 të Gjykatës së Kasacionit.

Kërkuesit parashtrojnë si shkak për antikushtetutshmërinë e vendimit të Gjykatës së Kasacionit, mohimin e së drejtës themelore të pronës nëpërmjet një procesi të parregullt ligjor, pasi është shkelur në mënyrë flagrante parimi i gjësë së gjykuar.

GJYKATA KUSHTETUESE,

Pasi dëgjoi shpjegimet e përfaqësuesve të kërkuesve, të subjektit të interesuar dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Sipas nenit 131 gërma “f” të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, Gjykata Kushtetuese gjykon përfundimisht ankesat e individëve për shkeljen e të drejtave të tyre kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave. Mbi këtë bazë bëhen objekt shqyrtimi në Gjykatën Kushtetuese dhe ato çështje gjyqësore të paraqitura nga individët për shkeljen e të drejtave të tyre pasi vendimi i gjykatës ka marrë formë të prerë dhe nuk ekzistojnë më mjete dhe rrugë ligjore për mbrojtjen e këtyre të drejtave.

Gjatë kohës që kjo çështje shqyrtohej në Gjykatën Kushtetuese, me Ligjin nr.8432, datë 14.12.1998 “Për disa ndryshime në Kodin e Procedurës Civile”, janë parashikuar mundësi ligjore për mbrojtjen e të drejtave të individëve nëpërmjet një rruge të jashtëzakonshme. Sipas nenit 5 të këtij ligji, kundër vendimeve të formës së prerë, vendimeve të mospranimit të rekursit, si dhe vendimeve të kolegjeve të Gjykatës së Lartë, palët kanë të drejtë që për shkaqet e parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “c” të nenit 472 të Kodit të Procedurës Civile, të bëjnë rekurs në Kolegjet e Bashkuara brenda 3 vjetëve nga marrja e vendimit formë të prerë. Në këto kushte Gjykata Kushtetuese, si garantuese e Kushtetutës, jo vetëm që duhet të krijojë mundësi individëve për të konsumuar edhe këtë mjet ligjor që ia njeh ligji i porsadalë, por njëkohësisht nuk mund të shkelë nenin 131/ f të Kushtetutës, që e ndalon shqyrtimin e mëtejshëm të këtyre çështjeve.

Me hyrjen në fuqi më datë 26.1.1999 të Ligjit nr.8432, datë 14.12.1998 “Për disa ndryshime në Kodin e Procedurës Civile”, shqyrtimi i kësaj çështjeje nuk është në juridiksionin e

Gjykatës Kushtetuese, derisa të konsumohet dhe mjeti i fundit ligjor për palët në proces, duke iu drejtuar Gjykatës së Lartë.

PËR KËTO ARSYE ;

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 131/f dhe 133 të Kushtetutës, njëzëri,

V E N D O S I:

Rrëzimin e kërkesës për mungesë juridiksioni.
Ky vendim është i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Tiranë, më 23.3.1999
Nr. 11 i regjistrit themeltar
Nr. 29 i vendimit.